

#17 




MAJ

2022



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Pristina



KONFERENCA PUBLIKE - PARANDALIMI I KORRUPSIONIT



Më 19 maj, në ambientet e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicën e Veriut, Organizata Joqeveritare Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) organizoi konferencën publike “Parandalimi i Korrupsionit”. Konferenca trajtoi reagimin institucional ndaj korrupsionit në komunat veriore, me theks të veçantë në qasjen në informata me rëndësi publike dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në reduktimin e korrupsionit. Panelistë ishin z. Naim Qelaj, Avokati i Popullit të Kosovës, z. Millosh Marković, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe z. Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC.



KLINIKA JURIDIKE MOBILE NË SHTRËPCË

Në kuadër të projektit “Iniciativa për Edukim kundër Dhunës në Familje dhe Seksuale”, OJQ ACDC organizoi aktivitetin në Shtërpçë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e parandalimit dhe veprimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me një qëllim të përgjithshëm për mbrojtjen e grave si grupi më i rrezikuar. Projekti zbatohet nga Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) në bashkëpunim me Institutin Kosovar të Drejtësisë dhe OJQ ACDC.

DISKUTIM PUBLIK ME PRAKTIKANTËT E DREJTËSISË

Në ditën e fundit të majit, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike – OJQ ACDC organizoi diskutim publik me avokatët e rinj. Diskutimi kishte për qëllim prezantimin e praktikantëve të rinj në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe prezantimin e përvojave të tyre në institucionet gjyqësore, vështirësitë me të cilat ballafaqohen për shkak të dallimeve në sistemet gjyqësore dhe mënyrat për tejkalimin e tyre. Praktikantët Milena Mitroviq, Bojana Srblak dhe Velisha Vuçuroviq morën pjesë në diskutimin publik.

Diskutimi është pjesë e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës", financuar nga INL, dhe zbatuar nga OJQ ACDC në partneritet me OJQ AKTIV.



PËRGATITJA PËR SIMILIMIN E GJYKIMIT TË DISKUTUESHËM

Gjatë këtij muaji, praktikantët e angazhuar e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës" ishin duke kryer aktivitetet fillestare dhe përgatitjen e një rasti për simulimin e gjyqimit të diskutueshëm, i cili do të organizohet në qershor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

NËNSHKRIMI I MEMORANDUMEVE TË MIRËKUPTIMIT ME KOMUNAT E VERIUT

OJQ ACDC gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje me komunat e veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicën e Veriut. Memorandumet e mirëkuptimit nënshkruhen në kuadër të projekteve aktuale dhe të ardhshme që kanë të bëjnë me përmirësimin e punës së komunës si dhe të institucioneve që janë në kompetencë të saj.

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT I NËNSHKRUAR ME OJQ SANTA MARIA



Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković dhe OJQ Santa Maria nënshkruan Memorandum mirëkuptimi në lidhje me projektet e vazhdueshme në lidhje me promovimin dhe mbështetjen e të drejtave të grave

VIZITA E AMBASADORIT TË SHBA-SË

Drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, është takuar me ambasadorin e SHBA-ve në Kosovë, z. Jeffrey M Hovenier në udhëtimin e tij të parë komunal jashtë Prishtinës. Gjatë këtij udhëtimi, ambasadori Hovenier u takua edhe me përfaqësues të organizatave tjera joqeveritare për të diskutuar situatën aktuale në Mitrovicë dhe të ardhmen e saj.



SESIONE TRAJNIMI

Në kuadër të projektit “Lehtësimi i qasjes në drejtësi dhe promovimi i të drejtave të njeriut në rajonin e Mitrovicës”, mbështetur nga UNMIK-u, është mbajtur trajnimi për barazi gjinore me zyrtarët komunalë për të drejtat e njeriut/gjini/mosdiskriminim/komunitete/kthim nga komunat: Mitrovica Jugore, Skenderaj dhe Vushtrri.

Si pjesë e projektit Promovimi i Dialogut Ndëretnik në Pushtetin Lokal, OJQ ACDC zhvilloi një sërë trajnimesh me anëtarët e Komitetit për Komunitete në Mitrovicën e Veriut, duke përfshirë përfaqësuesit komunalë dhe shoqërinë civile. Qëllimi i trajnimit ishte fuqizimi i Komitetit, duke trajnuar anëtarët e tij mbi menaxhimin e ciklit të projektit, avokimin dhe arritjen e rezultateve.



M4Y

Në maj përfundoi procesi i aplikimit për grante nga 4000 deri në 15000 dollarë. Grupet rinore joformale kanë aplikuar për projekte që do të përfitojë komuniteti. Gjatë procesit të aplikimit, trajnerët tanë mbajtën konsultime të rregullta me pjesëmarrësit dhe i ndihmuan ata në procesin e shkrimit. Ky projekt po zbatohet në dhjetë komuna të Kosovës, ndërsa ACDC është në krye të komunave: Vushtrri, Skenderaj, Zvečan, dhe Ranillug.

FUSHATË MEDIATIKE PËR TË PROMOVUAR DIVERSITETIN KULTUROR

Që nga muaji i ardhshëm, OJQ ACDC do të zhvillojë fushatë publike për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe për të promovuar ndërgjegjësimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërkulturor për kulturat dhe shprehjet kulturore të ndryshme.

OP-ED MBI SFIDAT E TË RINJVE NË LETËRSI DHE PROMOVIMIN E LEXIMIT

Poetja e re nga veriu i Kosovës, Anxhela Virijeviq, në tekstin “Rinia dhe Letërsia: Ruajtja e historisë përmes poezisë” ka shkruar se çfarë i motivon poetët e rinj nga veriu i Kosovës, nga e marrin frymëzimin dhe cilat janë temat poezive të tyre.

Slobodan Masiq, shkrimtar nga Kosova shkroi një op-ed mbi sfidat me të cilat përballen të rinjtë në letërsi

E projektit Përkrahja e Autorëve të Rinj në Dialogun Ndërkulturor dhe promovimin e diversitetit kulturor, i përkrahur nga fondi i BE-së për Rrjetëzim Regjional për Diversitetin Kulturor - READ

THIRRJE PUBLIKE DHE OP-ED PËR ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË PAGJETUR

Në maj, OJQ ACDC hapi thirrjen për shkrimin e tekste, duke ftuar autorët të shkruajnë OP-ED për të promovuar pajtimin rajonal dhe për të adresuar çështjen e personave të pagjetur në konfliktin e Kosovës. Tekstet fituese u publikuan në faqen e internetit të OJQ ACDC.

Lulzim Hakaj, bashkëthemelues i REC, vuri në dukje rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së personave të pagjetur si një nga shtyllat kryesore të ballafaqimit me të kaluarën dhe natyrisht përfshirjen e pashmangshme të institucioneve përkatëse që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e këtij problem.

Dragana Zhivkovic, anëtare e Shoqatës së Personave të Zhdukur, i'u referua të drejtës për pajtim të bazuar në falje, të drejtën për të zbuluar të vërtetën dhe bashkimin në mënyrë që drejtësia të fitojë, si dhe luftën për të paharrueshmem dhe të vërtetën, pavarësisht se cili Zot i lutemi dhe cilën gjuhë përdorim.

Silvana Marinkovic, koordinatorë e Shoqatës së Personave të Pagjetur dhe Rrëmbyer nga Graçanica, i'u referua faktit se dhimbja dhe vuajtja e çdo familjeje janë të njëjta. Në tekstin e mëposhtem, Silvana Marinkovic, do t'u kërkojë të gjithëve të bashkohen për një të ardhme më të mirë dhe një bashkëjetesë më të lumtur të brezave të ardhshëm.

Miroslav Markovic theksoi faktin se të pagjeturit duhet të jenë baza e pajtimit mes dy palëve, një urë që lidh drejtësinë dhe pajtimin dhe që do të shërbejë si një kujtim i vuajtjes që nuk duhet të përsëritet kurrë.